



**COVID-19
VACCINE**
Public Health
Advice

Vaksina Covid-19

Informacion i Rëndësishëm në lidhje
me Vaksinën COVID-19 Moderna,
Çfarë mund të prisni pas vaksinës tuaj
COVID-19 Spikevax (Moderna)

Versioni 9

9 Gusht 2021



Rialtas na hÉireann
Government of Ireland

Rreth kësaj fletushke

Kjo fletushkë ju tregon rreth vaksinës COVID-19 (koronavirus). Jutregon se:

- çfarë është COVID-19
- çfarë është vakcina COVID-19
- kush duhet të bëjë vaksinën
- pse është e rëndësishme ta merrni vaksinën
- kush nuk duhet ta marrë dhe kush mund ta shtyjë marrjen evaksinës
- siguria e vaksinës dhe efektet anësore
- ku mund të merrni më shumë informacion

Ju lutem lexojeni këtë fletushkë me kujdes. Gjithashtu, mund të flisnime një profesionist siç është Mjeku apo Farmacisti juaj në lidhje me vaksinën.

Çfarë është COVID-19?

COVID-19 është një sëmundje e cila prekë mushkëritë dhe rrugët tuajatë frymëmarrjes, shpeshherë edhe pjesët tjera të trupit. Shkaktohet nganjë virus i quajtur koronavirus.

COVID-19 është shumë infektues. Ai përhapet përmes ajrit dhe pikavetë prodhuara kur njerëzit kolliten ose teshtinë, ose kur prekin sipërfaqetku ka pika dhe pastaj prekin sytë, hundën ose gojën.

COVID-19 mund të shkaktojë sëmundje serioze, shtrim në spital, madje edhe vdekje.

Simptomat e zakonshme të COVID-19 përfshijnë:

- ethe (temperaturë të lartë 38 gradë Celsius ose më shumë)
- kollë – mund të jetë çfarëdolloj kolle, jo vetëm kollë e thatë
- vështirësi në frymëmarrje
- humbje ose ndryshim i ndjenjës së të nuhaturit apo të shijuarit – kjo do të thotë që nuk mund të nuhasësh aposhijosh më, ose gjërat kanë shije dhe erë tjetër

Mund të mos i keni të gjitha këto simptoma por nuk ndiheni mirë sizakonisht. Simptomat mund të zgjasin rreth 14 ditë për tu shfaqur. Mund të jenë të ngjashme me simptomat e ftohjes apo gripit.

Nëse keni ndonjë nga simptomat e COVID-19, vetë-izolohuni (qëndroninë dhomën tuaj) dhe dhe bëni një tests për COVID-19.

Për më shumë informacion rreth COVID-19, ju lutemi vizitoni **www.hse.ie/coronavirus** ose telefononi HSELive në

1800 700 700.

Kush është më i rrezikuar nga COVID-19?

Njerëzit e moshuar dhe ata me probleme të tjera shëndetësore janë më të rrezikuarit nëse preken nga COVID-19.

Çfarë është vakcina e COVID-19?

Vaksina është një substancë që duhet të përmirësojë imunitetin (mbrojtjen) ndaj një sëmundjeje të veçantë. Vaksina COVID-19 do t'ju ofrojë mbrojtje nga COVID-19. Nëse njerëzit vaksinohen, kjo gjithashtu duhet të zvogëlojë numrin e atyre që sëmuren rëndë apo edhe vdesin nga COVID-19.

Vaksinat mësojnë sistemin imunitar se si të mbrohet nga sëmundjet. Është shumë më e sigurt për sistemin tonë imunitar të mësojë se si tëna mbrojë përmes vaksinimit sesa duke u infektuar me COVID-19.

Kush duhet ta bëjë vaksinën?

Listën e grupeve mund ta shihni në faqen:

www.gov.ie/covid19vaccine

Edhe pse varet nga ju se a do ta merrni vaksinën, HSE,

Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Departamenti i Shëndetit rekomandojnë fuqishëm që ta bëni këtë posa t'ju ofrohet.

Vaksinat do të jepen ndërsa furnizimi arrin në Irlandë.

Kur të jetë radha juaj, ne do t'ju tregojmë se si të merrni vaksinën tuaj përmes reklamimit ose ftesës së drejtpërdrejtë. Është e rëndësishme të mos kontaktoni HSE për vaksinim para kësaj.

Do të duhet të lexoni këtë broshurë dhe fletushkën e informacionit të prodhuesit për pacientin para se të merrni vaksinën. Fletushkën e Informacionit të prodhuesit për Pacientin mund ta gjeni në **www.hse.ie/covid19vaccinePIL**

Gjithashtu mund të flisni me një profesionist të kujdesit shëndetësor paraprakisht. Nëse vendosni të merrni vaksinën, do të jepni pëlqimin tuaj i cili do të regjistrohet.

HSE po e ofron vaksinën falas.

Pse është e rëndësishme ta marrim vaksinën COVID-19?

Marrja e vaksinës duhet të ulë mundësinë e marrjes së

COVID-19 dhetë ju mbrojtë nga ndërlikimet serioze të COVID-19. Qëllimi ynë nëofrimin e vaksinës është që popullsia të mbrohet dhe të zvogëlojmënumrin e të prekurve dhe vdekjeve që ka shkaktuar ky virus.

Unë e kam kaluar COVID-19, a duhet ta marr vaksinën?

Po. Edhe nëse tashmë e keni kaluar COVID-19, mund ta merrnipërsëri.

Vaksina do të zvogëlojë rrezikun e riinfektimit me COVID-19. Edhenëse përsëri infektoheni me COVID-19, vakcina mund të zvogëlojëseriozitetin e simptomave tuaja

Unë kam tani COVID-19, a duhet ta marr vaksinën?

Jo. Duhet ta shtyni për më vonë marrjen e vaksinës, pasi të kaloniCOVID-19.

Shtyjeni për:

- për të paktën katër javë pasi u janë lajmëruar simptomat e para ose
- katër javë pasi të keni bërë testin dhe keni dalë pozitiv meCOVID-19

Marrja e vaksinës

Kush është vaksinuesi im?

Vaksinuesi juaj është personi që ju jep vaksinën. Ata janë trajnuar nga HSE për të dhënë vaksina COVID-19.

A mundet vaksina COVID-19 t'ju japë COVID-19?

Jo. Vaksina e COVID-19 nuk mund t'ju japë COVID-19. Është e mundur të keni marrë COVID-19 para se të merrni vaksinën tuaj dhe të mos e kuptoni se keni simptoma deri pas vaksinimit.

Nëse keni ndonjë simptomë të COVID-19, është e rëndësishme të vetë-izoloheni (qëndroni në dhomën tuaj) dhe të bëni një test falas për të zbuluar nëse keni COVID-19.

Nëse keni ethe që fillojnë më shumë se dy ditë pasi të keni bërë vaksinën, ose zgjasin më shumë se dy ditë, duhet të vet-izoloheni dhe të bëni një test për COVID-19.

Nëse keni simptoma pas dozës së parë, përsëri duhet të merrni dozë të dytë. Ndërsa mund të fitoni pak mbrojtje nga doza e parë, marrja e dozës së dytë do t'ju japë mbrojtjen më të mirë kundër virusit.

A duhet ta marr vaksinën e COVID-19 nëse kam temperature të lartë?

Jo. Duhet të shtyni marrjen e vaksinës nëse keni ethe (temperaturë 38 gradë Celsius ose më lart), derisa të ndiheni më mirë.

A duhet ta marr vaksinën gjatë shtatzënisë apo ushqyerjes me gji?

Nuk ka asnjë provë se vakcina COVID-19 është e pasigurt gjatë shtatzënisë.

Vaksinat COVID-19 nuk u testuan tek gratë shtatzëna në provat klinike. Sidoqoftë, mbi 100,000 gra shtatzëna në SH.B.A. kanë bërë një vaksinë COVID-19. Asnjë shqetësim i sigurisë nuk është identifikuar për ta ose për foshnjat e tyre.

Rekomandohet që të merrni vaksinën tuaj COVID-19 kur ju ofrohet. Vaksinimi do të zvogëlojë mundësinë që të sëmurëni rëndë.

Nëse jeni shtatzëne, duhet të flisni me Obstetrin ose Mjekun për marrjen e vaksinës COVID-19.

Mund të merrni vaksinën e COVID-19 nëse jeni duke ushqyer me

gji.

Cila vaksinë po më ofrohet?

Vaksina që po ju ofrojmë quhet Spikevax. Vaksina prodhohet nga Moderna.

Kjo vaksinë mRNA mëson trupin tuaj se si të prodhojë një proteinë qëdo të shkaktojë një përgjigje imune, pa përdorur virusin e gjallë që shkakton COVID-19.

Trupi juaj më pas prodhon antitrupa që ndihmojnë në luftimin e infeksionit nëse virusi hyn në trupin tuaj në të ardhmen.

A është e sigurt vaksina?

HSE përdor vetëm vaksinat kur ato plotësojnë standardet e kërkuara të sigurisë dhe efikasitetit.

Edhe pse puna për zhvillimin e vaksinave COVID-19 ka ecur shumë më shpejt se zakonisht, vaksina që po ju ofrojmë ka kaluar të gjithë hapat e zakonshëm, të nevojshëm për të zhvilluar dhe miratuar një vaksinë të sigurt dhe efikase.

Në mënyrë që të aprovohet për përdorim, vaksina COVID-

19 ka kaluar nëpër të gjitha provat klinike dhe kontrollet e sigurisë që kalojnë të gjithë ilaçet e tjera të licencuara, duke ndjekur standardet ndërkombëtare të sigurisë.

Vaksina që po ju ofrojmë quhet Spikevax. Vaksina prodhohet nga Moderna.

Ajo është:

- ✓ testuar tek mijëra njerëz si pjesë e provave klinike
- ✓ plotësoi standarde të rrepta të sigurisë, cilësisë dhe efikasitetit dhe u miratua dhe licencua nga rregullatorët. Për Irlandën, rregullatori është Agjencia Evropiane e Ilaceve (AEB) - vizitoni faqen e internetit www.ema.europa.eu për më shumë informacion.

Si jepet vakcina e COVID-19?

Vaksina COVID-19 jepet si injeksion në pjesën e sipërme të krahut. Zgjatë vetëm disa minuta.

Sa doza të vaksinës së COVID-19 duhet të marr?

Do t'ju duhen dy doza të vaksinës COVID-19 për të marrë mbrojtjen më të mirë. Duhet të merrni dozën e dytë 28 ditë (katër javë të plota) pas dozës së parë.

Cilat janë efektet anësore të vaksinës?

Si të gjitha ilaçet, vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore. Shumica e tyre janë të lehta deri të moderuara, afatshkurtra, dhe jo tëgjithë i hasin ato.

Rreth një në 10 persona mund të hasë:

- ndihet i lodhur
- ndjeshmëri, ënjtje, skuqje ose kruarje në krah, ku kanë bërë injeksionin e vaksinës
- dhimbje koke
- gjëndra limfatike të fryrë nën krah, ku kanë bërë injeksionin
- dhimbje muskulare
- dhimbje kyçesh
- marrje mendsh apo të vjella
- ethe (temperaturë 38 gradë Celsius ose më shumë)

Paraliza e Bell është një efekt anësor i rrallë që nuk shihet në më shumë se 1 në 10,000 njerëz. Rrallë, njerëzit që kanë pasur mbushëstë fytyrës mund të kenë ënjtje të fytyrës. Kjo është parë në rreth 1 në 10,000 njerëz.

Efektet anësore serioze, siç është reaksioni i rëndë alergjik, janë jashtëzakonisht të rralla, të vërejtura në afërsisht 2-3

në një milion njerëz. Vaksinuesi juaj është trajnuar për të trajtuar reaksione alergjike shumë serioze.

Shumë rrallë, tek njerëzit mund të shfaqet miokarditi dhe perikarditi pasi të kenë marrë vaksinën Moderna (Spikevax). Miokarditi dhe perikarditi janë gjendje inflamatore të zemrës. Rreziku i këtyre gjendjeve shumë të rralla është më i lartë tek meshkujt e rinj.

Miokarditi u raportua në rreth 1 në 1.000.000 doza vaksine. Sidoqoftë, të dhënat nga Shtetet e Bashkuara vlerësojnë se, pas dozës së dytë të vaksinës, rreziku i miokarditit është më i lartë për burrat e rinj. Rreziku i vlerësuar është:

- 1 në 16,000 meshkuj të rinj të moshës 12-17 vjeç pas dozës së dytë
- 1 në 20,000 meshkuj te rinj të moshës 18-24 vjeç.
- 1 në 100,000 gra të reja të moshës 12-17 vjeç

Perikarditi u raportua në rreth 1 në 1.000.000 doza vaksine.

Këto gjendje ka më shumë gjasa të ndodhin pas dozës së dytë dhe kryesisht ndodhin brenda 14 ditëve nga marrja e vaksinës.

Vaksina COVID-19 ka kaluar të njëjtat prova klinike dhe kontrole sigurie si të gjitha vaksinat e tjera të licencuara, megjithatë vaksina është e re dhe informacioni për efektet anësore afatgjate është i kufizuar.

Gjithnjë e më shumë njerëz në Irlandë dhe në të gjithë botën marrin këtë vaksinë, më shumë informacione mbi efektet anësore mund të bëhen të disponueshme. HSE do të azhurnojë këtë informacion rregullisht në faqen tonë të internetit, dhe nëse është e nevojshme, do të azhurnojë fletëpalosjet e informacionit të dhëna njerëzve në dozën e tyre të parë ose të dytë të vaksinës.

Temperaturë pas vaksinës

Është mjaft e zakonshme të zhvilloni ethe pas një vaksinimi. Zakonisht, kjo ndodh brenda dy ditësh (48 orë) nga marrja e vaksinës, dhe zhduket brenda dy ditësh.

Ka më shumë të ngjarë që të keni ethe pas dozës së dytë të vaksinës.

Nëse nuk ndiheni mirë, merrni paracetamol ose ibuprofen siç udhëzohet në kuti ose fletëpalosje. Nëse jeni të shqetësuar, ju lutem i kërkoni këshilla mjekësore.

Simptomat e miokarditit dhe perikarditit

Miokarditi dhe perikarditi janë gjendje që shkaktojnë inflamacion të zemrës. Edhe pse rreziku i këtyre gjendjeve është shumë i ulët, ju duhet të dini shenjat që duhet t'i vëreni.

Kërkoni ndihmë mjekësore nëse keni ndonjë nga këto simptoma pas vaksinës suaj Moderna (Spikevax):

- gulçim
- palpitacione (rrahje e fortë e zemrës që mund të jetë e parregullt)
- dhimbje gjoksi

A ka njerëz të cilët nuk duhet ta marrin vaksinën e COVID-19?

Po. Nuk duhet ta merrni vaksinën COVID-19 Moderna (Spikevax) nëse:

- keni pasur një reaksion të rëndë alergjik ndaj cilitdo prej përbërësve të vaksinës (përfshirë glukol polietileni ose PEG). Lexoni fletëpalosjen e prodhuesit të informacionit për pacientin për të parë listën e përbërësve.
- keni pasur një reaksion të rëndë alergjik ndaj një doze të mëparshme të vaksinës ose vaksinës Pfizer/BioNTech (Comirnaty).
- keni pasur një reaksion të rëndë alergjik pas Trometamolit (një ngjyrë kontrasti e përdorur në studimet radiologjike MRI)
- nga një mjek ju është thënë që nuk duhet ta merrni vaksinën Pfizer/BioNTech (Comirnaty), dhe as vaksinën Moderna (Spikevax) COVID-19
- keni pasur miokardit pas një doze të mëparshme të kësaj vaksine ose vaksinës Pfizer/BioNtech (Comirnaty) COVID-19.

Bisedoni me mjekun tuaj para se të merrni vaksinën kundër COVID-19 nëse

- keni pasur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) në të kaluarën, përfshirë ndonjë vaksinë ose ilaç tjetër.
- keni pasur perikardit pas një doze të mëparshme të kësaj vaksine ose vaksinës Pfizer/BioNtech (Comirnaty) COVID-19

Shumica e njerëzve do të jenë në gjendje ta marrin vaksinën. Personiqë ju bën vaksinën do të jetë i lumtur t'ju përgjigjet në çdo pyetje që keni gjatë kohës kur e merrni vaksinën.

Ata gjithashtu do t'ju japin një fletëpalosje të kujdesit pas vaksinës, dhe një kartë regjistrimi të vaksinës që tregon emrin dhe numrin e serisë së vaksinës që ju është dhënë.

Sa kohë i duhet vaksinës për të dhënë efekt?

Pasi t'i keni marrë të dyja dozat e vaksinës COVID-19, shumica e njerëzve do të kenë imunitet. Kjo do të thotë se ata do të mbrohen nga COVID-19.

Duhet 14 ditë pasi të merrni dozën e dytë që ajo të funksionojë.

Ekziston mundësia që akoma mund të infektoheni me COVID-19, edhe nëse e merrni vaksinën.

A ka vakcina efekt të çdokush?

Në mbarë botën, vaksinat shpëtojnë të paktën 2 deri në 3 milion jetë çdo vit dhe mbrojnë shumë më tepër nga sëmundjet e përjetshme. Miliona njerëz tani kanë marrë vakcina COVID-19 në të gjithë botën.

Ka dëshmi të forta, të besueshme se vaksinat kundër COVID-19 zvogëlojnë shumë rrezikun tuaj për të marrë COVID-19. Ato janë shumë efektive në parandalimin e vdekjeve dhe sëmundjeve serioze nga COVID-19.

Nëse keni një sistem imunitar të dobësuar, nuk ka rrezik shtesë në marrjen e vaksinës, por mund të mos funksionojë aq mirë për ju.

Pasi të marr vaksinën, a do të thotë kjo që nuk mund tashpërndajë COVID-19 tek të tjerët?

Ne nuk e dimë akoma nëse vakcina ju ndalon që të përhapni virusin COVID-19 tek të tjerët. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që të gjithë të vazhdojmë të ndjekim këshillat e shëndetit publik se si të ndalojmë

përhapjen e virusit.

Në veçanti, ju akoma duhet të:

- ndiqni rregullat e distancimit social (mbani 2 metra distancë nga njëri-tjetri)
- vendosni një maskë
- lani duart rregullisht

Faleminderit që mbroni veten dhe të tjerët.

Sa kohë zgjatë imuniteti nga vakcina?

Ne nuk e dimë akoma se sa do të zgjasë imuniteti. Provat klinike janë duke vazhduar për ta zbuluar këtë informacion.

Më shumë informacion

Për më shumë informacion, lexoni fletëpalosjen e informacionit të prodhuesit për pacientin. Kjo do të printohet për ju ditën kur merrnivaksinën tuaj, ose mund ta gjeni në faqen

www.hse.ie/covid19vaccinePIL

Gjithashtu mund të flisni me një profesionist shëndetësor, si mjeku juaj përgjithshëm, farmacisti ose ekipi i kujdesit shëndetësor.

Mund të vizitoni faqen e internetit të HSE në **www.hse.ie/covid19vaccine** ose telefononi HSElive në numrin 1800 700 700.

Për më shumë informacion rreth vaksinës COVID-19, përfshirë materiale të tjera në gjuhë të tjera, vizitoni

www.hse.ie/covid19vaccinematerials

Si t'i raportoj efektet anësore?

Ashtu si me të gjitha vaksinat, ju mund të raportoni efektet anësore të dyshuara tek Autoriteti Rregullativ i Produkteve Shëndetësore (HPRA).

HPRA është autoriteti rregullator në Republikën e Irlandës për ilaçet, pajisjet mjekësore dhe produktet e tjera shëndetësore. Si pjesë e rolit të saj në monitorimin e sigurisë së ilaçeve, HPRA operon një sistem përmes të cilit profesionistët e kujdesit shëndetësor ose anëtarët e publikut mund të raportojnë çdo reagim anësor të dyshuar (efekte anësore) të lidhura me ilaçe dhe vakcina që kanë ndodhur në Irlandë.

HPRA inkurajon raportimin e reagimeve të padëshiruara (efekteve anësore) të lidhura me vaksinat COVID-19 për të

mbështetur monitorimin e vazhdueshëm të përdorimit të tyre të sigurt dhe efikas. Për të raportuar një efekt anësor të dyshuar të vaksinës COVID-19, julutemi vizitoni

www.hpra.ie/report

Ju gjithashtu mund të kërkonti që mjeku juaj ose një anëtar i familjes të raportojë për ju. Duhet të jepen sa më shumë informacione që keni dhe kurdo që është mundur, numri i grupit të vaksinave duhet të shënohet.

HPRA nuk mund të ofrojë këshilla klinike në raste individuale. Anëtarët e publikut duhet të kontaktojnë profesionistin e tyre shëndetësor (Mjekun ose Farmacistin e tyre) për çdo shqetësim mjekësor që mund të kenë.

Informacioni juaj personal

Në mënyrë që vaksina të administrohet në mënyrë sa më të sigurt dhe të regjistronen të gjitha informacionet e nevojshme për të monitoruar dhe menaxhuar vaksinën, HSE do të përpunojë informacionin tuaj personal. Të gjitha informacionet e përpunuara nga HSE do të jenë në përputhje me ligjet epërgjithshme dhe veçanërisht me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (RPM) e cila hyri në fuqi në vitin 2018.

Përpunimi i të dhënave tuaja do të jetë i ligjshëm dhe i drejtë. Ato do të përpunohen vetëm për një qëllim specifik, për të menaxhuar vaksinimet. Parimet e Minimizimit të të Dhënave janë zbatuar. Kjo do të thotë se vetëm të dhënat që janë të nevojshme për t'ju identifikuar, për të caktuar takimin tuaj, për të regjistruar vaksinën tuaj dhe për të monitoruar efektet e tij, janë duke u regjistruar.

Ju keni të drejtat e mëposhtme si subjekt i të dhënave nën RPMD në lidhje me të dhënat tuaja personale që po përpunohen.

- Të kërkonti informacion dhe qasje në të dhënat tuaja personale (i njohur zakonisht si 'kërkesë për qasje të subjektit në të dhëna'). Kjo ju mundëson të merrni një kopje të të dhënave personale që ne mbajmë për ju dhe të kontrolloni nëse ne po i përpunojmë ato në mënyrë të ligjshme.
- Të kërkonti korrigjimin e të dhënave personale që ne mbajmë për ju. Kjo ju mundëson që të keni të korrigjuar çdo informacion jo të plotë ose të pasaktë që ne kemi në lidhje me ju.
- Të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja personale. Kjo ju mundëson të na kërkonti të fshijmë ose të heqim të dhëna personale atje ku nuk ka ndonjë arsye të mirë që ne të vazhdojmë t'i përpunojmë ato. Ju gjithashtu keni të drejtë të na kërkonti të fshijmë ose të heqim informacionin tuaj personal atje ku keni ushtruar të drejtën tuaj për të kundërshtuar përpunimin.
- Të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale.

Për më shumë informacion vizitoni:

www.hse.ie/eng/gdpr

Pas vaksinës tuaj COVID-19 Spikevax (Moderna)

Ju falënderojmë që po e mbroni veten tuaj dhe të tjerët duke e bërë vaksinën. Tani që e keni bërë vaksinën, ju lutemi të lexoni me vëmendje këtë dokument, në mënyrë që të dini se çfarë të prisni dhe sido të ndiheni ditët e ardhshme, dhe ku mund të merrni më shumë informacione.

Lexoni edhe broshurën e informacionit për vaksinën COVID-19 që ju dhamë.

Gjithashtu, po ju japim një kartelë si provë të vaksinimit tuaj sot.

Ju lutemi ruajeni kartelën e vaksinimit në mënyrë të sigurt.

Çfarë mund të ndodhë në ditët në vijim?

Disa persona që kanë bërë vaksinën që e keni bërë ju sot:

- do të kenë ndjeshmëri, fryrje, skuqje dhe/ose kruarje në pjesëne krahut ku i është dhënë injeksioni i vaksinës
- do të ndjehen të lodhur
- do të kenë dhimbje koke
- do i fryhen gjëndrat limfatike poshtë krahut ku i është bërëinjeksioni
- do të kenë dhimbje të muskujve
- do të kenë dhimbje të nyjeve
- do të kenë të përziëra ose të vjella
- do të kenë temperaturë (temperaturë e lartë prej 38 gradëCelsius ose mëlartë)

Tek një numër shumë i vogël i njerëzve që morën vaksinën u shfaq miokarditi (inflamacion i muskujve të zemrës) dhe perikarditi (inflamacion i mbështjellësit të zemrës).

Rreziku i këtyre smundjeve shumë të rralla është më i lartë tek meshkujt e rinj. Ka më shumë gjasa të ndodhë pas dozës së dytë dhe kryesisht ndodh brenda 14 ditëve nga marrja e vaksinës.

Duhet të kërkonti ndihmë të shpejtë mjekësore dhe të përmendni vaksinimin tuaj të fundit nëse:

- keni gulçim
- keni palpitacione (një rrahje e fortë e zemrës që mund të jetë e parregullt)
- keni dhimbje gjoksi

Siç është rasti me të gjitha vaksinat, mund të raportoni efektet anësoretë dyshuara tek Autoriteti Rregullator i Produkteve Shëndetësore (HPRA). Për të raportuar efektet anësore nga një vaksinë COVID-19, julutemi vizitoni **www.hpra.ie/report**

Çfarë të bëj nëse kam temperaturë ose dhimbje?

Nëse keni temperaturë ose dhimbje, mund të merrni paracetamol ose ibuprofen për t'ju ndihmuar. Megjithatë, nëse temperatura vazhdon të jetë e lartë për më shumë se 48 orë ose nëse keni akoma shqetësime, ju lutemi të kërkonti këshillën e mjekut. Mos merrni ibuprofen nëse jeni shtatzënë.

A duhet të bëj diçka përpara se të marr dozën e dytë të vaksinës?

Kur t'ju administrohet doza e ardhshme dhe e fundit e vaksinës, ju lutemi të njoftoni ekipin e vaksinimit nëse keni

pasur ndryshime në historinë tuaj mjeksore.

Merrni me vete kartelën e vaksinimit kur të shkoni ta merrni dozën edytë.

Kjo do të ndodhë pas 28 ditësh (katër javë).

Lajmet e mira

Administrimi i një vaksine COVID-19 duhet të ju mbrojë ngandërlikimet që mund të shkaktojë COVID-19.

Vaksina mëson sistemin imunitar të mbrohet nga sëmundja. Është shumë më e sigurtë që sistemi imunitar ta mësojë këtë nëpërmjet vaksinës sesa duke u infektuar me COVID-19.

Akoma jemi duke mësuar

Për të pasur efekt, nevojiten 14 ditë pas marrjes së dozës së dytë. Ekziston një mundësi e vogël që të infektoheni në vazhdim me COVID-19, edhe pse keni bërë vaksinën.

Nuk e dijmë akoma nëse vaksina do të pengojë përhapjen e virusit tek personat tjerë, andaj duhet të vazhdoni të respektoni rekomandimet e shëndetit publik:

- respektoni udhëzimet në lidhje me distancimin social
(mbani distancë pre 2 metrave nga të tjerët, nëse është e mundur)
- mbulonit fytyrën
- lani duart rregullisht.

Keni pyetje?

Nëse nuk jeni i/e sigurt për ndonjë gjë ose keni pyetje në lidhje me vaksinën COVID-19, ju lutemi bëjani këto pyetje sot personit që ju bënëvaksinën.

Vizitoni **www.hse.ie/covid19vaccine** për më shumë informacione përvaksinën COVID-19.

Efektet anësore

Ju lutemi të raportoni çdo efekt anësor tek HPRA në **www.hpra.ie/report**

Publikuarnga HSE më 9 Gusht 2021.

Për informacionin më të azhurnuar vizitoni **www.hse.ie**



Rialtas na hÉireann
Government of Ireland